


Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë periudhës raportuese, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në bazë të prioriteteve të përcaktuara me Planin e Punës, Strategjisë Komunale për Bujqësi 2017-2019/20, Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës 2014 - 2020, Planit Zhvillimor Komunal, ligjeve, vendimeve, akteve tjera normative, kërkesave të ndryshme si dhe bashkëpunimin me shoqatat e fermerëve dhe grupet tjera.

Në janar të vitit 2018 në DBPZHR kanë qenë të punësuar 18 punëtorë, ndërsa në muajin korrik, qershor- dhjetor dhe shtator të këtij viti, numri i të punësuarve ka arritur deri në 24. Nga ky numër i përgjithshëm i të punësuarve, punëtorë të rregullt kanë qenë 18, me kontrata për shërbime të veçanta 6 dhe 1 praktikant .

Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes profesionale në DBPZHR është e dominuar nga punëtorët me përgatitje të mesme 72.3 %, me përgatitje lartë profesionale të profilit Agronom 16.7%, të lartë profesionale – profile tjera 11%.



Përgatitja Profesionale	Numri i të punësuarve	Pjesëmarrja në %
Agronom	3	16.7
Veteriner	1	5.5
Inxhinier i pyjeve	1	5.5
Shkolla e mesme	13	72.3
Gjithsej	18	100%

I tërë aktiviteti i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural është zhvilluar sipas sektorëve:

- **Sektori i Bujqësisë**
- **Sektori i Zhvillimit Rural**
- **Sektori i Pylltarisë**

Gjatë këtij viti janë pranuar gjithsej 1930 kërkesa me shkrim nga lami të ndryshme, si dhe janë proceduar 957 fletë aplikime në kuadër të masave për mbështetje direk të sektorit e blegtorisë, vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimeve për MBPZHR.

-Sektori i Bujqësisë-

Aktivitetet kryesore ka pasur: realizimin e projekteve kapitale të financuara nga Kuvendi Komunal, monitorimin e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore, organizimin e fushatës së korrje shirjeve, bashkëpunimin me organizatat e ndryshme për përmirësimin e pozitës së fermerëve, vlerësimin e dëmeve të fushës dhe dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe mbajtjen e evidencës për tokën bujqësore (të papunuar, të dhënë në shfrytëzim dhe të cilës i është ndërruar destinimi i shfrytëzimit).

Projektet e financuara nga DBPZHR

Nr	Projekti	Vlera e projektit €	Shuma e paguar €	Për pagese €
1.	Vaksinim i qenve kundër tërbimit	7000.00	7000.00	0
2.	Riparimii rrugëve fushore	24396.93	18386.38	0
3.	Pjelloria e tokës dhe rekomandimi për plehërim	34700.00	34700.00	0
4.	Furnizimi me farë misri	26945.00	26945.00	0
5.	Rehabilitimi i kanaleve ujtitëse dhe kulluese	29044.80	18505.86	10538.94
6.	Ngritja e 50 serrave me participim	161720.00	147380.58	14339.42
7.	Furnizimi me motokultivator dhe mjete të imta	149820.00	149820.00	0
8.	Hartimi i projekteve për nevojat e drejtorisë	3216.00	3216.00	0
9.	Dezinsektimi dhe derratizimi i qytetit	34209.50	14012.00	0
10.	Furnizimi me 80 lopë qumështore	123040.00	123040.00	0
11.	Ngritja e 15 stallave për lopë qumështore	88349.00	82479.90	5889.95
12.	Trajtimi i qenve endacak	39960.00	29621.00	10339.00
13.	Ngritja e 10 stallave për bagëti të imtë	76300.00	76300.00	7630.00
14.	Ndërtimi i strehimores për qentë endacak	34000.00	0.00	34000.00
15.	Ngritja e 3 ha. me pemë arnore me participim	26097.00	26000.00	97.00
16.	Ngritja e 4 ha. me pemë të imta	81506.00	81506.00	0
17.	Furnizimi me farë gruri	77700.00	77700.00	0
18.	Hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore	38637.00	38637.00	0
	Totali	1066641.23	955250.17	82834.31

Në vazhdim po japim përshkrimin e projekteve:

1. Vaksinimi kundër tërbimit – Rabies:

Vaksinimi i qenve me përkujdesje kundër sëmundjes së tërbimit – rabies ka një rëndësi të veçantë pasi që prioritet ka mbrojtjen e shëndetit të popullatës. Për këtë qëllim janë vaksinuar 3.500 qenë me përkujdesje. Vlera e projektit është në shumë prej 7.000 €.

2. “Riparimi i rrugëve fushore”

Me realizimin e këtij projekti fermerëve ju është mundësuar qasje më e lehtë deri në prona bujqësore si dhe zvogëlim i shpenzime të transportit dhe rrezikshmërinë gjatë kryerjes së punëve në fushë.

3. Pjelloria e tokës dhe rekomandimi për plehërim”

Ky projekt është realizuar sipas dinamikës së planifikuar dhe ka të bëjë me realizimin e analizave agrokimike të tokave bujqësore në sipërfaqe prej 2.000 ha. Me këto analiza është përcaktuar: niveli i materies organike, ph- ja e tokës, përmbajtja e materieve aktive për makro dhe mikro elemente, si dhe rekomandimi për plehërim.

4. “Subvencionimi i fermerëve me farë misrit”.

Është subvencionuar mbjellje e 800 ha. me misëri. Përfitues janë 630 fermerët e komunës së Prizrenit të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara. Shuma e projektit 26.945 €.

5. “ Rehabilitimi i kanaleve ujitëse”

Ky projekt ka të bëjë me krijimin e kushte për prodhimtari intensive dhe shtimin e sipërfaqeve me ujitje tokë e bonitetit 1–4. Zgjerimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore në Piranë, Landovicë, Krajk, Tupec dhe Gjonaj në sipërfaqe prej 350 ha. nga sistemi i ujitjes “Radoniqi – Dukagjini” është në përfundim e sipër. Vlera e këtij projekti është 650.000 € investim i MBPZHR.

6. “Ngritja e 50 serrave me participim”.

Kultivimit të perimeve në ambiente të mbrojtura - serra është duke iu kushtuar vëmendje e posaçme për shkak të disa përparësive siç janë: furnizimi i tregut gjatë pranverës së hershme dhe vjeshtës së vonshme me perime të freskëta, siguria nga fatkeqësitë elementare, rendimenti i lartë, etj. Për këtë qëllim janë ngritur 50 serra me nga 1000m² 500m² dhe 240m² në bashkëfinancim me fermerët.

7. “Furnizimi me motokultivator dhe mjete të imta bujqësore”

Realizimi kualitativ i punëve të fushë është një prej faktorëve kyç për rritjen e prodhimit. Për këtë qëllim 60 fermerë që merren me kultivimin e pemëve, vreshtave dhe perimeve në ambiente të mbrojtura (serra) dhe në fushë të hapur janë furnizuar me motokultivator.

8. Hartimi i projekteve për nevojat e drejtorisë”

Me këtë projekt është realizuar synimi i hartimit të projekteve detale për kategori të ndryshme (serra, stalla, kanale, etj.).

9. “Dezinsektimi dhe Derrratizimi i qytetit”

Për shak të vonesave në procedura të prokurimit dhe ankesave te operatorve ekonomik konkurrues, është vonuar nënshkrimi i kontratës për dezinfektimin e qytetit. Kontrata është nënshkruar në fund të muajit shtator dhe për këtë arsye është realizuar vetëm derrratizimi.

10. “Furnizimi me 80 lope qumështore” Janë shpërndarë 80 lopë qumështore të gjithë fermerëve që i kanë plotësuar kriteret përzgjedhëse. Ky projekt ka ndikim në përmirësimin racor në ferma.

11. “Ngritja e 15 stallave për lopë qumështore”

Në bashkëfinancim me fermerët janë ngritur 15 stalla për mbarështimin e lopëve qumështore. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i kushteve në fermë dhe rritja e produktivitetit.

12. Trajtimi i qenve endacak me metodën e eutanazisë.

Me këtë projekt po arrihet mbajtja nën kontroll dhe parandalimin i përhapjes së sëmundjes së Tërbimit tek kafshët. Ky projekt është duke vazhduar sipas normave standarde dhe praktikave mjekësore veterinarë.

13. “Ngritja e 10 stallave për bagëti të imta”

Përmirësimi i pozitës së fermerë sa i përket mbarështimit të deleve dhe dhive është një nga prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm lokal të komunës së Prizrenit. Për arritjen e këtij synimi në bashkëfinancim me fermerët janë ngritur 10 stalla për mbarështimin e tyre.

14. “Ndërtimi i strehimores për qenë endacak” Janë përfunduar të gjitha punët përgatitore dhe është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik. Ky projekt vazhdon edhe në vitin 2019.

15. Ngritja e 3 ha. me pemë arrore”

Janë ngritur 3 ha. me pemë arrore. Përfitues janë të gjithë fermerët e interesuar për këtë veprimtari.

16. Ngritja e 4 ha. me pemë të imta”

Në kuadër të këtij projekti janë ngritur 4 ha. me pemë të imta kryesisht dredhëza.

17. “Subvencionimi i fermerëve me farë gruri”

Është subvencionuar mbjellje e 1.000 ha. me grurë. Përfitues janë rreth 1350 fermerët të komunës së Prizrenit të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara.

18. Hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore” Fermerëve që i punojnë sipërfaqet tokësore ku nuk ka sisteme të integruar të ujitjes i është mundësuar hapja e puseve për ujitje. Përfitues janë 52 fermerë të zonave të ndryshme bujqësore.

-Sektori i Zhvillimit Rural-

Janë realizuar një mori aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e standardit të ekonomive bujqësore duke përfshirë edhe ato të diversifikimit rural si masë shtesë e rritjes së të ardhurave. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është që fermerët të bëhen të pavarur në menaxhimin e fermave të tyre.

Me këtë kemi arritur të bëjmë një klasifikim të plotë të kategorive të fermerëve që në të ardhmen do të na shërbej në realizimin e projekteve madhore.

Përveç realizimit të objektivave të parapara nga drejtoria, sektori i Zhvillimit Rural ka bashkëpunuar edhe me shumë organizata qeveritare e jo qeveritare me qëllim të përmirësimit të situatës në fermat bujqësore dhe ekonominë rurale.

Aktivitetet tjera:

- Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore dhe krijimi i rrjetit të të dhënave të kontabilitetit të fermës.
- Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore është lejuar për 5 raste në sipërfaqe prej 28.660 m² dhe janë inkasuar 20.830 €.
- Monitorimi i mbjelljeve pranverore, vjeshtore dhe përgatitjet për korrije.

Bazuar në Planin e Punës për vitin 2018, në harmoni me kompetencat e veta dhe kërkesat e punës, drejtoria ka kryer aktivitetet e parapara të kontrollit fizik në terren, verifikimi i deklarimeve të përfituesve, hartimi me shkrim i të gjeturave dhe formulimi i Raporteve të Kontrollit si dhe informimi për të gjeturat, konstatimet dhe nivelin e realizimit të projekteve.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural varësisht prej nevojës është angazhuar në mënyrë aktive edhe në shumë aktivitete tjera të iniciuara nga autoritete të ndryshme publike në nivel lokal, regjional dhe qendrore.

SEKTORIT I PYLLTARISË

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3. (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi degën e ekzekutivit të Institucioneve të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe nenit 20,25 dhe 29 të Ligjit për pyjet e Kosovës Nr. 2003/3 të dt. 20 mars 2003, nenit 12 pika 29.8 të Ligjit nr. 03/L-153 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/3 për pyjet e Kosovës, UA-05,06,07 /2010 si dhe Memorandumit të Mirëkuptimit mes MBPZHR dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës

NJËSITË PYJORE janë kompetencë e deleguar në Komuna nga MBPZHR-APK, dhe Komunat asnjë buxhet nuk kanë ndarë për sektorin e pylltarisë 2018

Pylltaria ndahet në tre sektorë:

1. Sektori i Mbrojtjes së Pyllit – **gjatë kësaj periudhe janë ngritur 18 fletëparaqitje për kundërvajtje dhe 17 fletëparaqitje penale. për dëmtues 380 kontrole, natën dhe ditën.**
2. Sektori i Shfrytëzimit të Pyllit – **janë tenderuar 1458.72 m³ dru në këmbë, në Koritnik, Malet e Sharrit, derisa 1409.58 m³ është furnizuar popullata e zonave rurale. Koritnik, Malet e Sharrit , Pashtrik, Koxha Ballkan**
3. Sektori i pyjet private- **janë pranuar 89 kërkesa të pronarëve në pyjet private, 59 të realizues dhe 30 pa realizuar.**

Pyllëzimet:

Janë mirëmbajtur pyllëzimet e viteve paraprake

50 hektar në fshatin Vlashnje- Kobaj, 50 hektarë në Sredskë

2 hektar në Lubizhdë të Prizrenit

Drejtori

Egzon Elshani